

# Udhëzues për hapjen e llogarive bankare në Irlandë



Për personat që kërkojnë Azil ose që u është dhënë statusi sipas ligjit ndërkombëtar për mbrojtjen të vitit 2015 (International Protection Act 2015)



**Ky udhëzues është për njerëzit që janë aplikues për mbrojtje ndërkombëtare ose që kanë marrë së fundi statusin si të tillë sipas ligjit ndërkombëtar për mbrojtjen të vitit 2015 (International Protection Act 2015).**

Ky udhëzues ju tregon se çfarë ju duhet për të hapur një llogari bankare.

Në të ka informacion që ju ndihmon për ta bërë sa më të lehtë këtë proces.

## **Sistemi bankar në Irlandë**

- Bankat në Irlandë mirëpresin aplikuesit (azilkërkuesit dhe refugjatët) si klientë bankarë
- Stafi i degës do t'ju ndihmojë që të bëni aplikimin
- Stafi i bankës është trajnuar që të ndihmojë të gjithë klientët
- Banka do të marrë në konsideratë se sa të përshtatshme janë produktet dhe shërbimet e saj financiare për klientin
- Sipas ligjit kundër pastrimit të parave, bankave u kërkohet të verifikojnë identitetin tuaj duke parë disa dokumente të caktuara
- Nëse nuk i keni dokumentet standarde që kërkohen, banka mund të pranojë dokumente të tjera por kjo mund të kërkojë pak më shumë kohë
- Në shumicën e rasteve do t'ju duhet të lini një takim për të hapur një llogari bankare

# Pse duhet të hapni një llogari bankare?

**Të gjithë kemi nevojë për llogari bankare që t'i administrojmë paratë në mënyrë të efektshme dhe të sigurt.**

Ka shumë lloje të ndryshme llogarish. Banka do t'ju japë informacion për t'ju ndihmuar të zgjidhni se cila llogari është e përshtatshme për nevojat tuaja. Me një llogari bankare, ju:

- ✓ mund t'i mbani paratë të sigurta
- ✓ mund të merrni pagën ose ndihmat drejtpërdrejt në llogarinë tuaj
- ✓ mund t'i administroni faturat në mënyrë të efektshme
- ✓ mund të kontrolloni shpenzimet dhe kursimet tuaja
- ✓ mund të përdorni karta pagesash dhe bankën online, nëse doni



# Çfarë ju duhet për të hapur një llogari bankare në Irlandë

Sipas ligjit kundër pastrimit të parave, bankave u kërkohet të konfirmojnë identitetin tuaj dhe të verifikojnë adresën tuaj. Për të hapur një llogari në një degë të bankës, duhet të jepni të paktën një dokument si **mjet identifikimi** dhe një dokument tjetër si **vërtetim adrese**.

**Mos harroni:** Dokumentet që pranohen mund të ndryshojnë në varësi të bankës. Këshilloheni fort që të kontaktoni bankën që keni zgjedhur nëse nuk i keni dokumentet standarde. Banka mund t'ju thotë se çfarë dokumentesh të merrni me vete kur vini për të hapur llogarinë tuaj.



## Mjeti i identifikimit

Format standarde të mjetit të identifikimit:

- **Pasaportë**
- **Leje drejtimi automjeti** - BE ose irlandeze

Banka juaj do të pranojë dokumente alternative si mjete identifikimi, nëse nuk keni as pasaportë, as leje drejtimi. Ndër to përfshihen, për shembull:

- **Leje qëndrimi irlandeze**
- **Vërtetim banimi të përkohshëm**
- **Dokument udhëtimi nga qeveria irlandeze** (I nxjerrë nga OKB)

## Vërtetimi i adresës

Format standarde të vërtetimit të adresës:

- **Faturë utilitetesh e kohëve të fundit**


Për shembull, një faturë gazi ose energjie elektrike, me datë brenda gjashtë muajve të fundit

- **Deklaratë bankare e kohëve të fundit**

me datë brenda gjashtë muajve të fundit

- **Njoftim për përcaktimin e krediteve për vitin aktual**

- **Letër nga një departament qeveritar**



Banka juaj do të pranojë dokumente alternative si vërtetim adrese. Ndër to përfshihen, për shembull:

- **Letra e lejes për të pasur qasje në tregun e punës**
- **Letër nga një departament qeveritar ose zyrë tjetër për mbrojtje ndërkombëtare**

Letër e drejtuar direkt për bankën, ku konfirmohet statusi juaj si aplikues për mbrojtje ndërkombëtare dhe adresa juaj e plotë e banimit

- **Letër nga qendra e sigurimit direkt (Direct Provision Centre) ose qendra e pranimit të emergjencave dhe orientimit (Emergency Reception and Orientation Centre - EROC) ku jetoni**

Letër me kokë

## Sugjerime

- Vërtetimi i adresës suaj duhet të jetë i kohëve të fundit (më pak se 6 muaj) dhe i vlefshëm, dhe duhet të keni një mjet identifikimi që është aktual
- Emri në fotografinë e mjetit të identifikimit duhet të përputhet me emrin në vërtetimin tuaj të adresës
- Llogaritë e ndryshme bankare pranojnë dokumente të ndryshme, ndaj kontaktojini para se të bëni aplikimin për të mësuar se çfarë pranojnë
- Faqet e internetit bankare kanë një listë të gjërave që pranojnë. Merrni sa më shumë forma mjeteve identifikimi dhe vërtetime adresash që të mundeni
- Është më mirë të lini një takim me degën e bankës për të hapur një llogari
- Mund të hapni një llogari bazë pagese (të njohur si llogari bankare bazë në Irlandë), nëse NUK e keni një llogari të tillë apo një llogari tjetër bankare në Irlandë apo në ndonjë vend tjetër të BE-së

Është më mirë të lini një takim me degën për të hapur një llogari.



# Çfarë duhet të dini kur hapni një llogari bankare

- Bankat ndjekin shumë rregulla kur hapin llogari bankare të reja Në shumicën e rasteve, mund të duhen disa ditë që një degë të hapë llogarinë tuaj
- Nëse është e mundur, shikoni faqen e internetit të bankës para se të shkoni në degë
- **Lini një takim për të shkuar në degën e bankës që keni zgjedhur**
- Për të hapur një llogari bankare, duhet të merrni me vete dokumentet që tregohen të pjesa "Çfarë ju duhet për të hapur një llogari bankare"
- Do t'ju duhet të jepni disa informacione bazë. Shikoni shembullin e një aplikimi për llogari bankare në faqen tjetër
- Ju lutem pyesni stafin e degës nëse keni pyetje
- Stafi i degës dëshiron t'ju ndihmojë. Nëse nuk e dinë përgjigjen, ata do të pyesin personat e duhur në bankën e tyre dhe do të përpiqen të marrin përgjigjen tuaj sa më parë
- Mund të doni që dikush t'ju ndihmojë të lini një takim dhe/ose të vijë në bankë me ju. Ka shumë të ngjarë që banka t'i kërkojë këtij personi të japë mjet identifikimi
- Mos harroni se nëse nuk keni dokumentet standarde, jo të gjitha bankat kërkojnë të njëjtat dokumente. Flisni me bankën para se të shkoni që të jeni sa më të përgatitur
- Merrni me sa më shumë dokumente që të mundeni, të cilat vërtetojnë adresën dhe identitetin tuaj

## Të dhënat personale

\*Titulli Z.  Znj.  Tjetër  Trego këtu

\*Emri

\*Mbiemri

\*Adresa

\*Rrethi  \*Shteti

Gjinia Ma.  Femër

Statusi mar. Martuar/Partner civil  Beqar  Divorcuar  I/E ve  Tjetër

\*Datëlindja Dita  / Muaji  / Viti

Vendlindja (sipas mjeteve të identifikimit)

Rrethi/Qyteti i lindjes  Shteti

Qëllimi i llogarisë

Veprime të përditshme  Tjetër

Burimi i të ardhurave: Nga do të vijnë paratë që do të futen në llogari. Për shembull – pagat ose asistencat sociale. Sa para prisni të futni në llogari rregullisht?

## Të dhënat për punësimin

\*Lloji i punësimit

I punësuar  I vetëpunësuar  Shtëpiak  Në pension  I papunë aktualisht

Përshkrimi i punës

Emri i punëdhënësit

\*Të ardhurat vjetore bruto  (Nëse nuk keni të ardhura, shënoni 'zero', pra shkruani '0' te fusha e të ardhurave)

A do të paguhet të ardhurat në llogarinë tënde? Po  Jo

## Raportimi tatimor

(kërkohet me ligj për disa lloje llogarish)

## Të dhënat e kontaktit

Nr. telefonit të shtëpisë  Nr. i celularit.


Adresa e email-it

## Mënyra e preferuar e kontaktit

Telefon:  Email:  Postë:



**Kur të jepni dokumentet që kërkohen, banka do të procesojë aplikimin.**



- Nëse duhen dokumente shtesë ose dokumente të tjera, ajo do t'ju kontaktojë
- Nëse nuk mund ta pranojë aplikimin tuaj, do t'ju njoftojë sa më shpejt të jetë e mundur

**Për klientët e tyre, bankat ndjekin procesin për ankesat që përcaktohet te Kodi i Bankës Qendrore për Mbrojtjen e Klientit**

- Nëse nuk jeni të kënaqur me mënyrën se si banka sillet me ju, ose nëse besoni se punonjësit e bankës nuk po zbatojnë rregullat e Kodit për Mbrojtjen e Konsumatorit, fillimisht duhet të përpiqeni të ankoheni në bankë
- Bankave u kërkohet të kenë një procedurë për ankesat dhe t'i zgjidhni mosmarrëveshjet shpejt, në mënyrë të efektshme dhe të drejtë
- Nëse nuk jeni të kënaqur me mënyrën si po trajtohet ankesa juaj ose me përgjigjen që keni marrë në lidhje me ankesën tuaj, mund të kontaktoni Avokatin për Shërbimet Financiare dhe Pensionet (Financial Services and Pensions Ombudsman). Ky organ statutor i pavarur mund ta investigojë ankesën tuaj

Shikoni [www.fraudsmart.ie](http://www.fraudsmart.ie) dhe [www.safeguardyourmoney.ie](http://www.safeguardyourmoney.ie) për sugjerime dhe këshilla si t'i mbani paratë tuaja të sigurta dhe të parandaloni mashtrimet.



## Mashtrimi:

- **Informohuni:** Mbani situatën në kontroll, mos u nxitoni duke marrë një vendim që më pas do të pendoheni
- **Jini të vëmendshëm:** Kontrolloni gjithnjë email-ët, telefonatat ose mesazhet e rastësishme ose të papritura ku ju kërkohen informacione personale, biznesi ose financiare.
- **Mbrohuni:** Asnjëherë mos jepni të dhënat tuaja të sigurisë, si fjalëkalimin e bankës, kodet/detajet e identifikimit ose PIN-in.

## Abuzimi financiar:

- Abuzimi financiar është diçka që mund të vijë dalëngadalë, në mënyrë që të mos e kuptoni se ajo që po ndodh ndaj jush është e padrejtë e ndoshta e jashtëligjshme. Gjithashtu mund të bëhet më e ndërlikuar nga dikush që e njihni dhe tek i cili mbase keni besim
- Pavarësisht moshës, statusit ose aftësive tuaja, duhet të jeni të sigurt që paratë tuaja administrohen në mënyrë të drejtpërdrejtë e të sigurt, dhe për dobinë tuaj
- Nëse jeni merak për administrimin e parave tuaja, mund t'i kërkonit ndihmë bankës

**Mund të kërkonti këshilla për hapjen e një llogarie bankare nga:**

**Banks:**

**AIB**

[www.aib.ie](http://www.aib.ie)

0818 303203

**KBC Bank**

[www.kbc.ie](http://www.kbc.ie)

1800 939 244

**Bank of Ireland**

[www.bankofireland.com](http://www.bankofireland.com)

0818 365 365

**permanent tsb**

[www.permanenttsb.ie](http://www.permanenttsb.ie)

0818 50 24 24

**EBS**

[www.ebs.ie](http://www.ebs.ie)

1850 654321

**Ulster Bank Ireland**

[www.ulsterbank.ie](http://www.ulsterbank.ie)

1850 424 365

**Citizens Information Bureau:**

[www.citizensinformation.ie](http://www.citizensinformation.ie)

Shërbim telefonik në 0761 07 4000

(nga e hëna në të premte, 09:00 deri në 20:00)

**Consumer Hub, Central Bank of Ireland:**

[www.centralbank.ie/consumer-hub](http://www.centralbank.ie/consumer-hub)

**The Financial Services and Pensions Ombudsman:**

[www.fsppo.ie](http://www.fsppo.ie)

01 5677 000



[www.bpfi.ie](http://www.bpfi.ie)